



## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

**Studim:** Vlerësimi i afinitetit në mes nënshartesave më të rëndësishme me kultivarët kryesor të agrumeve. Studimi i mundësisë së përdorimit të tyre në rritjen e përshtatshmërisë së bimëve të Agrumeve ndaj kushteve tokësore të terreneve të zonës.

**Qëllimi:** Të përcaktojmë për secilën specie të Agrumeve nëshartesën më të mirë përse i përket përpuethshmërisë në momentin e shartimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të fidanit.

- Tu rekomandojmë fermerëve fidana prodhues, nënshartesat më të mira për secilën specie dhe gjithashtu fermerëve që do të investojnë për të ngritur një agrumishte të re, t'i orjetojmë drejt kultivarëve më të mirë dhe nënshartesave më të përshtatshme në varësi të kushteve klimatike dhe tokësore ku do të ngrihen plantacione të reja.

**Vendi i ngritjes së eksperimentit:** Serra e shumëzimit Shamogjin

**Periodha e studimit:** 2017-2019

U morën në studim 6 nënshartesat, dy tradicionalisht janë përdorur si Trifoljata, Nerënxa dhe katër nënshartesat të reja: Rubidox, Sw. Citrumelo, C. Carizo, C. Troyer.

Tre nënshartesat, Trifoljata, Rubidox dhe Nerënxë janë prodhuar një vit më parë në serrën e shumëzimit, këto vite u prodhuan filizat e nënshartesave C. Carizo, C. Troyer dhe Swingle Citrumelo. Farat e u morën në koleksionin e nënshartesave në Bazën Eksperimentale Shamogjin dhe u mbollën në farishte në muajin Dhjetor. U zbatua teknologjia e prodhimit të fidanëve, e njëjtë për të tre nënshartesat nga mbjellja e farës, trapjantimi në qeska definitive në muajin Prill dhe shërbimet e tjera.




**Figurë 1.** Pamje nga trapjantimi i filizave në Serrën e shumëzimit.

Pas mbjelljes në muajin Maj, u bën matjet për diametrin e kërcellit në afërsi të qafës së rrënjës dhe lartësinë e filizit. Këta tregues u morën gjithashtu dhe në muajin Nëntor. (Tabela)

**Tabelë 1.** Matja e diametrit (mm) dhe lartësisë (cm) e nënshartësave të agrumeve.

Nënshartesa	Maj	Lartësia cm	Nëntor	Lartësia cm
	Diametri mm		Diametri mm	
Sw. Citrumelo	3	22	6.2	38.1
C. Troyer	2.3	19	5.2	34.3
C. Carizo	2.6	20	5.1	34.2



**Grafikë 1; 2.** Të dhënat e diametrit dhe lartësisë së nënshartësave (Maj; Nëntor).

Bën diferencë nënshartesa Sw. Citrumelo si nënshartesë me zhvillim më të mirë si në diametër ashtu edhe në lartësi në momentin e shkuljes nga farishtja dhe mbjellja në qeskë. Zhvillimi i mëtejshëm i fidanit në raport me treguesit fillestar është pothuaj i njëjtë me dy nënshartesat e tjera.

Do të vazhdojnë shërbimet në fidanët e nënshartësave me qëllim që të bëjmë të mundur në muajin Maj 2018 të shartojmë të tre speciet e Agrumeve në të gjitha nënshartesat e mësipërme.

Specialist:

Lida Lazaj